





Ministria e Arsimit e Shkencës e Teknologjisë dhe Inovacionit

KOMUNA E PODUJEVËS

Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije OPSTINA PODUJEVO - MUNICIPALITY OF PODUJEVO

Ministry of Education, Science, Technology and Innovation

Prishtinë, \_\_\_/\_\_\_2025  
Nr. \_\_\_\_\_

Duke marrë parasysh nenet 4,21,22 të Ligjit nr. 03/L-189 për Administratë Shtetërore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare, nr. 82, 21 tetor 2010) si dhe duke u bazuar në Nenin 8, paragrafi 1.4 dhe Shtojcën 12 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenin 5 të Ligjit nr. 03/L-048 për Vetëqeverisje Lokale, Ligjin nr. 08/L-193 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, lidhet:

**MARRËVESHJE E MIRËKUPTIMIT PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT  
"NDËRTIMI I SALLËS SË SPORTIT NË SHFMU 'SHABAN SHALA' NË  
PODUJEVË"**

**Palët nënshkruese**

1. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, e përfaqësuar nga Ministrija e MASHTI (në tekstin e mëtejme MASHTI), dhe
2. Komuna e Podujevës, e përfaqësuar nga Kryetari Komunës (në tekstin e mëtejme Komuna).

## **Neni 1 Qëllimi**

Qëllimi i kësaj marrëveshje është realizimi i projektit **"Ndërtimi i sallës së sportit në SHFMU "Shaban Shala" në Podujevë"** si dhe përcaktimi i obligimeve të MASHTI-it dhe Komunës së Podujevës për realizimin e këtij projekti.

## **Neni 2 Vlera e projektit dhe mënyra e bashkëfinancimit**

2.1. Projekti **"Ndërtimi i sallës së sportit në SHFMU "Shaban Shala" në Podujevë"** ka vlerë para llogaritave prej 480,000.00€.

2.2. MASHTI financon këtë projekt nga buxheti me kodin: 19120 në vlerë prej 450,000.€ dhe atë: për vitin 2025 në shumën 130.000.00€, nga buxheti i vitit 2026 në shumën 300.000.00€ dhe nga buxheti i vitit 2027 në shumën 20,000.00€.

## **Neni 3 Obligimet e MASHTI**

3.1. MASHTI i zotën mjetet për projektin nga neni 2, pika 2.2 e kësaj Marrëveshje dhe një kopje e dërgon në Komunë.

3.2. Pagesat për projektin **"Ndërtimi i sallës së sportit në SHFMU "Shaban Shala" në Podujevë"** nga MASHTI, do të realizohen në bazë të realizimit të punimeve/furnizimeve sipas kushteve të kontratës.

3.3. MASHTI cakton një menaxher të projektit me vendim për monitorimin e projektit dhe raporton për fazën e punimeve si dhe pagesat pranohen nga menaxheri i caktuar nga MASHTI lidhur me këtë projekt, i cili monitoron projektin nga fillimi deri në përfundim të kontratës. Në momentin kur zyrtari monitorues vëren parregullsitë apo defekte gjatë realizimit të kontratës njofton menaxhmentin e MASHTI-it.

#### Neni 4 Obligimet e Komunës

- 4.1. Komuna është e obliguar që brenda 30 ditëve nga pranimi i Marrëveshjes së Mirëkuptimit të nënshkruar dhe protokolluar të sjellë në MASHTI projektin zbatues si dhe tërë dokumentacionin e nevojshëm i cili na siguron që projekti nuk do të ketë pengesa në realizim. MASHTI pas konfirmimit të tillë do të fillon me procedura të sigurimit për zotimin e mjeteve të dala nga MM.
- 4.2. Komuna financon për projektin në fjale shumën e mbetur prej: 30,000.00€.
- 4.3. Komuna obligohet që projektin **"Ndërtimi i sallës së sportit në SHFMU "Shaban Shala" në Podujevë"** ta zhvilloi në pajtim me legjislacionin në fuqi.
- 4.4. Komuna kryen procesin e tenderimit, cakton komision e hapjes dhe vlerësimit të tenderit.
- 4.5. Komuna cakton projekt menaxherin/organin mbikëqyrës për realizimin e projektit si dhe inspektimin final të punimeve/pranimin e punimeve.
- 4.6. Projekt menaxheri/organi mbikëqyrës me përgjegjësi të plotë vërteton sasitë dhe cilësinë e punëve/furnizimeve të kryera në bazë të cilave operatori ekonomik lëshon dokumentin financiar me kërkesë për kompensimin e punëve/furnizimeve të kryera në bazë të kushteve të kontratës.
- 4.7. Komuna obligohet që të njoftoj MASHTI-in për çdo propozim ndryshimi eventual të sasisë dhe cilësisë gjatë zbatimit të projektit, dhe për këtë të kërkoj pëlqimin e MASHTI-it.
- 4.8. Komuna obligohet që të vendos tabelën informuese (pano) standarde me shënimet për projektin, investitorët dhe operatorin ekonomik në vend punishte.
- 4.9. Komuna është e obliguar të njoftoi MASHTI-in për rrjedhat e realizimit të projektit sipas një plani dy javor deri në përfundim të projektit.
- 4.10. Çdo tejkalim i vlerës së planifikuar për projektet nga paragrafi 2 i këtij Memorandumi do të mbulohet nga Komuna.

**Neni 5**  
**Dokumentacioni i nevojshëm për pagesë nga Komuna**

- 5.1. Komuna obligohet që për të realizuar pagesat për punët/furnizimet e kryera në nivel të financimit nga ana e MASHTI-it, të kompletoj këto dokumente:
- 5.1.1. Procesverbalin e hapjes së tenderit dhe raportin e vlerësimit të tenderit (si dhe në rastet e korrigjimit të çmimeve të dorëzohen dokumentet e korrigjuara).
  - 5.1.2. Kopja e Kontratës së nënshkruar me operatorin ekonomik së bashku me ofertën financiare, të verifikuar nga origjinali prej menaxherit të prokurimit të komunës.
  - 5.1.3. Vendimi për caktimin e projekt menaxherit/organit mbikëqyrës/komisionit të pranimi nga ana e Komunës.
  - 5.1.4. Raportin e projekt menaxherit/organit mbikëqyrës/komisionit të pranimi mbi punët/furnizimet e kryera dhe të aprovuara (pozicionet e aprovuara).
  - 5.1.5. Faturën origjinale nga operatori ekonomik deri në lartësinë e shumës së financuar nga MASHTI.
  - 5.1.6. Kopjen e certifikatës së biznesit, llogarinë bankare dhe letërnjoftimin e pronarit të operatorit ekonomik *(nëse nuk është i regjistruar së SMIFK-Departamenti i Thesarit-Ministria e Financave)*.

**Neni 6**  
**Ndryshimet dhe ndërprerja e Marrëveshjes së Mirëkuptimit**

- 6.1. Me pëlqimin paraprak me shkrim të Ministrit të MASHTI dhe Kryetarit të Komunës marrëveshja mund të ndryshohet dhe të plotësohet.
- 6.2. MASHTI rezervon të drejtën e ndërprerjes së shfrytëzimit të buxhetit për këtë qëllim në rast se konstaton se Komuna nuk i përmbush obligimet e veta të dala nga kjo Marrëveshje.

**Neni 7**  
**Zgjidhja e marrëveshjes**

Palët janë pajtuar në mes veti që kjo marrëveshje të zgjidhet me mirëkuptim.

**Neni 8**  
**Numri i kopjeve**

Marrëveshja e Mirëkuptimit është nënshkruar në katër kopje, nga dy kopje për secilën palë nënshkruese.

**Neni 9**  
**Pronësia e projektit**

9.1. Me pranimi dorëzimin e punëve të kryera nga ana e operatorit ekonomik, ky investim (projekt) nga kjo Marrëveshje e Mirëkuptimit do kaloj në pronësi të Komunës.

9.2. Ky investim regjistrohet në pronësi të Komunës në mënyrë elektronike dhe fizike, në sistemin e pasurisë në Ministrinë e Financave (SMIFK).

**Neni 10**  
**Hyrja në fuqi**

Palët nënshkruese janë pajtuar që kjo marrëveshje e mirëkuptim të fillon të zbatohet nga dita e nënshkrimit.

Data 06/02/2025

**Arbërie Nagavci**  
**Ministria e MASHTI**



**Shpejtim Bulliqi**  
**Kryetar i Komunës së Podujevës**



**Neni 9**  
**Pronësia e projektit**

9.1. Me pranim dorëzimin e punëve të kryera nga ana e operatorit ekonomik, ky investim (projekt) nga kjo Marrëveshje e Mirëkuptimit do të kalojë në pronësi të Komunës.


9.2. Ky investim regjistrohet në pronësi të Komunës në mënyrë elektronike dhe fizike, në sistemin e pasurisë në Ministrinë e Financave (SMIFK).

**Neni 10**  
**Hyrja në fuqi**

Palët nënshkruese janë pajtuar që kjo marrëveshje e mirëkuptimit të fillojë të zbatohet nga dita e nënshkrimit.

Datë \_\_\_\_/\_\_\_\_/2024

Arbërie Nagavci  
Ministre e MASHTI


Shpejtim Bulliqi  
Kryetar i Komunës së Podujevës